



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 840 Prot.

Tiranë, më 16.03.2023

VENDIM

Nr. 19, DATË 15.03.2023

Bordi i Administrimit në vijim të shkeljes së rëndë dhe flagrante të konstatuar dhe të përmbledhur në Relacionin e datës 27.02.2023 dhe të miratuar unanimitisht në mbledhjen e Bordit të Administrimit të datës 15.03.2023 për shkelje të përmbushjes së detyrave të përcaktuara në shkonjën “ç”, pika 1 dhe pikës 2 të nenit 52 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në shkelje të shkronjës “c”, “ç”, dhe “d” të nenit 6, të shkronjës “b”, “d”, “rr” të pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 46 dhe nenit 66 të Statutit të UST, në shkelje të shkronjës “d”, pika 1 e nenit 27 dhe nenit 41 të Rregullores së UST dhe Rregullores së Bordit të Administrimit “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për punësimin e personelit administrativ në UST”, në votimin e datës 15.03.2023, me pjesmarrjen e të gjithë anëtarëve, në unanimitet, me 7 vota pro dhe asnjë votë kundër, në përputhje me pikën 3 të nenit 51 të ligjit nr. 80/2015, vendosi me votë “**PRO SHKARKIMIT**” të Administratorit të UST znj. Mirlinda Galushi.

Për sa më sipër Bordi i Administrimit në përputhje me germën “g”, pika 1 e nenit 49 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”:

VENDOSI:

1. Shkarkimin e Administratorit të UST znj. Mirlinda Galushi për shkelje të rëndë dhe flagrante në përmushjen e detyrave funksionale, në respektim me ligjin, Statutin dhe Rregulloren e UST.
2. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit si dhe Drejtoria e Burimeve Njerzore, Arkiv-Protokollit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

ANËTAR	ANËTAR	ANËTAR	ANËTAR
DRITAN SALLAKU	AIDA BENDO	ALTIN MËRTIRI	AIDA MËRTIRO
ANËTAR	ANËTAR		
SEAD BUSHATI	FATMIR YODOLLARI		
KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT			
ARTUR ÇOBANI			